

Vendim nr. 141 datë 24.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

Marjana Semini, Anëtare

në datën 24.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: AGRON JAHOLLARI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-775, datë 15.03.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 e 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Agron Jahollari (*kërkuesi*) ka qenë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (*QKR*) si person fizik me aktivitet tregtar në fushën e transportit të udhëtarëve.

Sikurse rezulton nga ekstrakti historik i lëshuar në datën 04.03.2014 nga QKR-ja ose edhe nga akte të tjera, në datën 05.04.2011, me kërkesën e tij ai e ka pezulluar përkohësisht aktivitetin e tij tregtar. Në vijim, në datën 06.05.2011, ai ka paraqitur kërkesë me shkrim në Bashkinë Korçë, përmes së cilës kërkonte pajisjen e tij me licencë për të ushtruar aktivitetin tregtar të transportit të udhëtarëve në shërbimin taksi 4+1.

2. Bashkia Korçë, me shkresën nr. 384/1 prot., datë 26.05.2011, e ka informuar kërkuesin se ai mund të pajisej me licencë 5-vjeçare për ushtrimin e aktivitetit taksi, vetëm pasi të paguante detyrimet financiare tatimore që kishte ndaj saj në bazë të legjislacionit në fuqi. Në rast se ai nuk do të rezultonte subjekt i detyrimeve të mësipërme, atëherë do të procedohej në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 të ministrit të Financave “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në bazë të të cilave ai duhej të paguante shumën e prapambetur të detyrimit tatimor. Ndër të tjera, Bashkia Korçë e ka njoftuar kërkuesin se në rast pamundësie financiare, ai duhej të bënte kërkesë për shlyerjen me këste të detyrimit tatimor të papaguar dhe se marrëveshja për shlyerjen e tij me këste nuk duhej të zgjaste më tepër se fundi i vitit të ardhshëm kalendarik pas hartimit të marrëveshjes.

3. Në këto rrethana, në datën 05.03.2014, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e palës së paditur, Bashkisë Korçë, t’i paguante atij vlerën e dëmit të pësuar si rezultat i mospajisjes me licencë për ushtrimin e profesionit taksist, në shumën 2.000.000 lekë.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 338, datë 13.06.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit, me arsyetimin se kërkimi i tij ishte i pabazuar në prova dhe në ligj, pasi pala e paditur nuk kishte kryer asnjë veprim ose mosveprim të kundërligjshëm që ka sjellë si pasojë të drejtpërdrejtë dëmtimin e interesave të tij të ligjshëm. Sipas gjykatës, mospajisja e kërkuesit me licencë nga Bashkia Korçë ka ardhur si pasojë e mosplotësimit nga ana e tij e një sërë kriteresh të përcaktuara nga ligji për t’u pajisur me licencë nga pala e paditur. Ky vendim është ankimuar nga kërkuesi.

5. Pas shqyrtimit gjyqësor të ankimit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2633, datë 09.12.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pasi ka vlerësuar se ai ishte rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural në raport me faktet e parashtruara përpara gjykatës. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-775, datë 15.03.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk i referohej asnjë prej shkaqeve ligjore që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 “Për

organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

7. Në datën 22.04.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 02.05.2024.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Së drejtës për t’u njoftuar dhe për t’u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dërguar njoftim personal për gjykimin e zhvilluar në dhomën e këshillimit, në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor. Megjithëse neni 6 i KEDNJ-së nuk mund të interpretohet sikur kërkohet një formë specifike e njoftimit përmes shërbimit të postës, është e nevojshme që kërkuesi të njoftohet në mënyrë të përshtatshme, me qëllim që të marrë dijeni për gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë. Njoftimi me shpallje duhet zbatuar si mjeti i fundit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili duhet të kishte vendosur thirrjen dhe njoftimin personal të kërkuetit, me qëllim moscenimin e së drejtës së tij për t’u dëgjuar dhe për të parashtruar në mënyrë efektive të gjitha pretendimet e tij.

8.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në lidhje me të drejtën e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, në përputhje me funksionet dhe detyrat e saj të përcaktuara në nenin 141 të Kushtetutës, si dhe nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, kishte detyrimin që ta merrte në shqyrtim themeli çështjen e kërkuetit dhe jo të vendoste mospranimin e rekursit të tij. Pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të ligjit material dhe atij procedural të zbatueshëm në rastin objekt shqyrtimi, si dhe natyra e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi është civile dhe, si e tillë, mund të zgjidhet vetëm nga gjykatat civile dhe nuk mund të jetë pjesë e asnjë juridiksioni tjetër.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuetit*

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin Kolegji çmon se ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

12. Për sa i takon legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 15.03.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 22.04.2024. Me anë të komunikimit elektronik të datës 17.05.2024, Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi gjyqësor është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 05.06.2023, datë në të cilën palët mund ta dispononin këtë vendim, ndërkohë që në rekursin e kërkuetit nuk

rezulton që jetë shënuar adresa e tij elektronike, në mënyrë që sekretaria e Gjykatës së Lartë të kishte mundësi për ta dërguar vendimin me *e-mail*.

14. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se kërkuesi pretendon se legjitimohet *ratione temporis*, pasi duke iu referuar shkresës nr. 210/1 prot., datë 18.04.2024 të Filialit të Postës Korçë rezulton se ai ka marrë dijëni në datën 20.12.2023 për vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili i është përcjellë bashkëlidhur shkresës nr. 6528/1 prot., datë 15.12.2023 të Gjykatës së Lartë, si përgjigje ndaj kërkesës së tij nr. 6528 prot., datë 14.12.2023. Këtë pretendim kërkuesi e ka mbështetur në qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështjen “*Supergrav Albania*” sh.p.k. kundër Shqipërisë”, datë 09.05.2023.

15. Bazuar në standardet e mësipërme, Kolegji çmon se si moment i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese të kërkuetit do të konsiderohet data 05.06.2023, kur vendimi i kundërshtuar është publikuar i arsyetuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Ndaj, edhe në këtë aspekt, pretendimi i kërkuetit se ka marrë dijëni për këtë vendim në datën 20.12.2023, datë në të cilën shërbimi postar i ka dorëzuar shkresën e Gjykatës së Lartë, përmes së cilës i është përcjellë vendimi i Kolegjit Administrativ të saj, në bazë të kërkesës së vetë kërkuetit, nuk qëndron nga pikëpamja kushtetuese.

16. Në përmbledhje të analizës si më lart, Kolegji vlerëson se në kushtet kur që prej datës 05.06.2023, kërkuesi konsiderohet se ka pasur mundësi të njihet me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar, vlerësohet se ankimi kushtetues individual i datës 22.04.2024 është paraqitur tej afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk përmbush kriterin e legjitimitetit *ratione temporis* për të paraqitur kërkesën drejtuar Gjykatës, sipas objektit.

17. Në këtë aspekt, duke pasur parasysh natyrën kumulative të kriterëve të pranueshmërisë së ankimit kushtetues individual, nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësimin të kriterëve të tjera të legjitimitetit të kërkuetit.

18. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.